



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe - EC MA NDYSHE

Rruga "Fehmi Lladrovci" 94, 20000 Prizren
Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5, 10000 Prishtinëinfo@ecmandryshe.org
038 224 967 & 029 222 771

THIRRJE PËR OFERTIM

Për investim në parkun e lagjes Lakuriq Prizren

Prapavija e projektit:

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është promovimi i hapësirave publike të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të qasshme në Prizren nëpërmjet dialogut të politikave, projekteve të hartuara dhe të demonstruara nga komuniteti, të cilat synojnë përmirësimin e jetesës së banorëve dhe komuniteteve të pafavorizuara.

Projekti do të përfshijë investim në hapësirat publike në lagjen Lakuriq (parku afër KEDS-it dhe dy hapësira tjera më të vogla në afërsi) ku është aplikuar metodologjia e EC-it për planifikim urban me pjesëmarrje (hartim nga ana e komunitetit) bashkë me metodologjinë ndërkombëtarisht të njohur MineCraft / Bllok për Bllok.

Ky projekt zbatohet nga EC Ma Ndryshe dhe Komuna e Prizrenit përderisa bashkë-financohet nga UN-HABITAT dhe Komuna e Prizrenit.

Subjekti i ofertës:

Ftohen subjektet e interesuara, që për nevojat e projektit të investimit në këto hapësira publike, sikurse që janë: punët ndërtimore, mobilaria urbane dhe punët tjera të përcaktuara me projekt, të paraqesin ofertat e tyre financiare. Afati i kryerjes së punimeve është Mars 2020.

Ofertuesit së bashku me oferta duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin shtesë:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit,
- Certifikata e regjistrimit fiskal,
- Certifikata e TVSh-së (kompanite që janë deklaruese të TVSH-së),
- Referenca mbi kryerjen e punëve të ngjashme të dëshmuara me kontrata apo letër-referenca,
- Çmimet të kotuara me Euro ku në çmim duhet të përfshihet edhe TVSH-ja.

Kriteret e perzgjedhjes:

Gjatë shqyrtimit të ofertave, EC Ma Ndryshe do të ketë për bazë këto kriteret të perzgjedhjes:

- Çmimi i volitshëm
- Përvoja e kompanisë në këtë fushëveprimtari
- Numri i stafit/punëtorëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm
- Referencat nga klientët

Aplikimi:

Informatat e nevojshme për ofertë dhe dokumentacionin përkatës për ofertim mund ta merrni përmes postës elektronike info@ecmandryshe.org me subjekt “Kërkesë për dokumentacion Parku Lakuriq” dhe atë deri më **18.12.2019**. Për më shumë informata mund të kontaktoni edhe në numrat e telefonit: **038 224 967, 029 222 771 dhe 049 372 639**.

Ofertat në zarf të mbyllur dorëzohen në zyret e EC Ma Ndryshe në Prizren Rruga "Fehmi Lladrovci" 94 apo në Prishtinë Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr. 5 deri më **31.12.2019, ora 16:00**, me shënimin: “Për parkun Lakuriq”. Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga kompanitë nëse e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Për më shumë informacione rreth thirrje për aplikim, ju lutemi vizitoni www.ecmandryshe.org/konkurse.

12 Dhjetor 2019